




REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
 AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
 AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
 ANTI-CORRUPTION AGENCY

Dep. _____
 Dep. DPK
 Nr. lfaq _____
 Broj stranica _____
 Nr. pages _____

Nr Prot. _____
 Bi Prot _____
 Prot No 03-02/4309/17
 Data _____
 Datum 29-12-2017
 Date _____

FRISHTINE



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 26.12.2017, mori:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. AKK-03-02-3728/17, për z. Valon Ramadani, Deputet i Kuvendit të Republikës së Kosovës, për shkak se zyrtari i lartë publik e ka shmangur gjendjen e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt Interesi në Ushtrimin e Funksionit Publik për zyrtarin e lartë, z. Valon Ramadani, Deputet i Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe njëkohësisht person i autorizuar në biznesin privat "Uni - Gv" Sh.P.K, është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik.

Zyrtari i lartë, fillimisht është njoftuar me një shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit, për fillimin e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit. Pas pranimit të kësaj shkrese, zyrtari i lartë është njoftuar me fakte për kufizimin e përcaktuar shprehimisht në Ligjin nr.04/L-051, për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, neni (15 paragrafi 1), në të cilin shprehimisht thuhet:

"Zyrtari i lartë nuk mund të jetë menaxher, anëtar i ndonjë organi menaxhues apo kontrollues i ndërmarrjeve private".

Prandaj, nga zyrtari i lartë është kërkuar të heq dorë nga ushtrimi i funksionit person i autorizuar në biznes privat për të shmangur gjendjen e konfliktit të interesit.

Zyrtari i lartë, është deklaruar se brenda afatit ligjor do të ndërmerr veprimet e nevojshme me qëllim të shmangies së konfliktit të interesit.

Ndërkohë, Agjencia kundër Korrupsionit ka pranuar një shkresë e lëshuar nga Agjencioni për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (DPKI.03-02/4193/17) me të cilën dëshmohet se zyrtari i lartë është larguar nga funksioni “personi i autorizuar” në biznesin privat të cekur më lartë. Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

II. Në mbështetje të nenit 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Shaip Havolli
Drejtore i Agjencisë kundër Korrupsionit

